



Prishtinë: 28.01.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1106\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_R\_1898\_01\_19.

në seancën e mbajtur më datë 28.01.2019, nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit “B” Shpk (përfaqësuar nga M.B.), si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 08.10.2018 konsumatori “B” të përfaqësuar nga Mustafë Borovci, në të cilën ankesë është theksuar se KEDS refuzon t’i lëshojë kompanisë në fjalë Pëlqimin Elektronenergjetik për kyçjen e paneleve solare për vetëkonsum për kapacitet 1000 kW.

Bordi i ZRRE-së, me qëllim të vërtetimit të plotë gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest.

Pas kërkesës që kompanisë “B” Shpk për marrjen e Pëlqimit Elektroenergjetik, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS me datë 17.08.2018 i ka lëshuar kompanisë “B” Shpk Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) nr.2588 për veprimtarinë objekti gjenerues – prosumer (vetëkonsum) me fuqi maksimale të njëkohshme prej 500 kW.

**Provë:** Pëlqimi Elektroenergjetik nr.2588 i datës 17.08.2018

Pas kësaj kompania “B” Shpk ka parashtruar prapë kërkesë në KEDS duke kërkuar Pëlqimin Elektroenergjetik për lejimin e kyçjes së paneleve solare me fuqi 1000 kW.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes – KEDS me datë 17.09.2018 i ka lëshuar kompanisë “B” Shpk një Informatë duke i theksuar se është analizuar kërkesa juaj e kyçjes së paneleve solare me fuqi 1000 kW në trafon  $S_n=2x630$  kVA, mirëpo nuk ju lejohet instalimi prej 1000 kW, por që sipas PEE nr.2588 të datës 17.08.2018 është lejuar instalimi prej 500 kW në bazë të fuqisë elektrike maksimale të ngarkuar në këtë trafo.

**Provë:** Informata e KEDS-it nr.9821 e datës 17.09.2018

Pas kësaj, kompania “B” Shpk i është drejtuar ZRRE-së me një kërkesë për shqyrtimin e pëlqimit elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS për gjeneratorin prodhues për vetëkonsum për refuzimin e lëshimit të pëlqimit për kapacitet prej 1000 kW. Në ankesën/kërkesën e kompanisë “B” Shpk përveç tjerash theksohet se, kompania “B” Shpk pajtohet me të gjitha kushtet teknike të dhëna në pëlqimin



elektroenergjetik të dhënë nga KEDS, përveç kapacitetit të theksuar në Pëlqim Elektroenergjetik e cila është dhënë 500 kW ndërsa kompania në fjalë sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi ka kërkuar PEE për kapacitet 1000 kW. Andaj kompania “B” Shpk kërkon nga ZRRE që të ipet Pëlqimi Elektroenergjetik për kapacitetin 1000 kW.

**Provë:** Ankesa/kërkesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së në muajin prill 2017 bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Energjinë ka aprovuar Rregullën Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme, në të cilën rregull përveç tjerash është përfshirë edhe një kapitull për skemën mbështetëse të gjeneratorëve me vet-konsum të BRE-ve, si dhe Rregullën Nr.11/2017 për Procedurën e Autorizimit të Ndërtimit të Kapaciteteve Gjeneruese.

Në nenin 25 të Rregullës Nr.11/2017 për Procedurën e Autorizimit, është trajtuar çështja e aplikimit për çdo person fizik apo juridik i cili planifikon të ndërtoj kapacitete të reja gjeneruese për vet – konsum, janë të obliguar që të parashtrijnë kërkesë me shkrim në ZRRE duke i plotësuar dëshmitë relevante si në vijim:

- Dëshmia nga KEDS për konsumin e energjisë vjetore;
- Vlerësimin për prodhimin vjetor në kWh të pajisjeve të instaluar;
- Pëlqimin për kyçje në rrejt të lëshuar nga KEDS; dhe
- Pëlqimin nga komuna përkatëse.

Vlen të theksohet se kompania “B” Shpk ka sjellur në ZRRE të gjitha dëshmitë e përcaktuara në nenin 25 të Rregullës Nr.11/2017 për Procedurën e Autorizimit, me një dallim që në Pëlqimin Elektroenergjetik të dhënë nga KEDS-i nuk është dhënë fuqia e kërkuar nga aplikuesi “B” Shpk prej 1000 kW, por është dhënë fuqia prej 500 kW në bazë të fuqisë elektrike maksimale të ngarkuar në këtë trafo.

Bordi i ZRRE thekson se në nenin 20 të Rregullës Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme, thuhet se: *“Çdo konsumator i energjisë elektrike i kyçur në tensionin e ulët të rrejtit të shpërndarjes mund të aplikoj tek furnizuesi i tij për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues, në përputhje me nenin 27 të Rregullës së Procedurës së Autorizimit dhe në përputhje me formularin e aplikimit në Shtojcën 3 dhe të njëjtin aplikacion duhet ta dorëzojë në Rregullator”*.

ZRRE duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë, konstaton se rregulla e definon qartë që kufizimi për aplikim për vet-konsum është i kufizuar me nivelin e tensionit (niveli 0.4 kV), pra një konsumator për të aplikuar për kyçjen e paneleve solare objektin e tij duhet të plotësoj kushtin ligjor të përcaktuar në Rregullën Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme.

Bordi i ZRRE-së thekson se konsumatori “B” Shpk në të cilën ka kërkuar nga KEDS Pëlqim Elektroenergjetik për kyçjen e paneleve solare për vetëkonsum për kapacitet 1000 kW ka shifrën DGL – 9028014 dhe është i kyçur në nivelin e tensionit 10kV, dhe se matja e energjisë elektrike e këtij konsumatori bëhet në po të njëjtin nivel tensioni. Andaj duke u bazuar në nenin 20 të Rregullës Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme, në të cilën theksohet se: *“Çdo konsumator i energjisë elektrike i kyçur në tensionin e ulët të rrejtit të shpërndarjes mund të aplikojë tek furnizuesi i tij për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues.....”*, atëherë konsumatori në fjalë nuk e plotëson kushtin ligjor për aplikim si konsumator prodhues për vetëkonsum. Pra, sipas dispozitave ligjore të Rregullës Nr.10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtritshme, përkatësisht nenin 20 të kësaj rregulle, çdo konsumator i cili është i kyçur mbi nivelin e tensionit 0.4kV nuk mund të aplikojë tek furnizuesi për të fituar statusin e konsumatorit prodhues për vetëkonsum, andaj edhe ankesa/kërkesa e konsumatorit refuzohet si e papazë.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit: “B” Shpk (përfaqësuar nga M. B.)
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.